



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:242517

Datë: 23.11.2023

Numri i dokumentit: 04964862

PPP.nr.35/23

GJYKATA THEMELORE NE PEJË- DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku në çështjen juridike - përbarimore te kreditores A.M të cilin e përfaqëson Amir Bunjaku avokat nga Prishtina, ndaj debitorit Komuna e Istogut- Drejtoria e Arsimit, në bazë të dokumentit përbarimor Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.394/22 i datës 21.08.2023, i formës së prerë me datën 25.09.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.10.2023, nga baza juridike borxh në shumë prej 812.60 euro, caktuar me urdhrin përbarimor të Përbaruesit Privat Argjent Xheladini në Prishtinë P.nr.255/23 të datës 10.10.2023, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës gjyqësore me datë 23.11.2023 bie këtë:

AKVENDIM

REFUZOHET NË TËRËSI SI I PABAZUAR, prapësimi i debitorit Komuna e Istogut, i parashtruar kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit të Përbaruesit Privat Argjent Xheladini në Prishtinë P.nr. 255/23 të datës 10.10.2023.

ARSYETIM

Kreditorja, ka parashtruar propozim për lejimin e përbarimit të Përbaruesi Privat Argjent Xheladini në Prishtinë P.nr. 255/23 të datës 10.10.2023, ndaj debitorit Komuna e Istogut, në bazë të dokumentit, Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.394/22 i datës 21.08.2023, i formës së prerë me dt.25.09.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.10.2023, nga baza juridike borxh në shumë prej 812.60 euro.

Përbaruesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditores ka caktuar urdhrin për përbarim P.nr.255/23 të datës 10.10.2023.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbartimor me datën 27.10.2023 duke theksuar se: përmbartuesit privat nuk mund të lejojn përmbartimin, në kontestet që rrjedhin nga mardhënja e punës, për këtë ka kompetencë vetëm gjykata, dhe përmbartuesi privat nuk mund të merr taksen në emër të shpenzimeve të përmbartuesit privat sepse kjo është në kundërshtim me Udhëzimin Administrative MD-01/22 përkatësisht me nenin 8 të këtij udhëzimi.

I autorizuari i kreditores ka dhënë përgjigje në prapësim duke shtuar së prapësimi është i pabazuar ngase në bazë të Ligjit nr. 08/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-118, përmbartuesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përmbartimit dhe zbatimin e përmbartimit të vendimeve gjyqësore, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës dhe tarifat e përmbartuesit privat janë të rregulluara me Udhëzimin Administrative MD-01/22 përkatësisht neni 4, par.2.

Gjykata në procedurë përmbartimore pas shqyrtimit dhe vlerësimit të prapësimit të debitorit, si dhe shkresave tjera të lëndës konstatoj se i njëjti nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, në bazë të të cilave shkaqe gjykata duhet ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Gjykata prapësimin e debitorit, e refuzoi si të pabazuar, duke ju referuar dokumentit përmbartimor përkatësisht Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.394/22 i datës 21.08.2023, i formës së prerë me dt.25.09.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.10.2023, e duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 24 të LPP-së i cili përcakton se: vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për mosveprim ose veprim është i pambarueshëm po që se është i formës së prerë, prandaj në rastin konkret dokumenti përmbartimor në bazë të të cilit është lejuar përmbartimi është i plotfuqishëm, dispozitiv i tij është i përshtatshëm dhe i përmbartueshëm, dhe i përcaktuar çartë detyrimi i debitorit ndaj kreditores. Gjykata vendosi si në pikën një të dispozitivit të këtij aktvendimi duke ju referuar edhe parimit të legalitetit rigoroz formal, ku gjykata në procedurë përmbartimore nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë materiale dhe të rregullsisë së dokumentit përmbartimor (titullit ekzekutiv), në bazë të të cilit e lejon përmbartimin, ngase në procedurë civile nuk lejohet gjykim i ri midis palëve të njëjta për çështjen juridike për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë.

Po ashtu gjykata i refuzoj kërkesën e debitorit për shtyrjen e ekzekutimit të aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 54 par. 1 pika 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbartimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbartimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet

kreditorit që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarimit, në qoftë se dokumenti përmbarues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 par. 1 të LPP-së i cili përcakton se: gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjatimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, konformë dispozitave ligjore të nenit 67 par.1 pika 1, nenit 71, dhe nenit 73 par.3 të LPP-së u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE NE PEJË- DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm,
Divizioni Civil PPP.nr.35/23, datë 23.11.2023**

G j y q t a r j a
Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes se të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.